



Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe në bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor Nr. 02/L-52:

Kopshti "NGJYRAT"

SHPALL KONKURS PËR REGJISTRIMIN E FËMIJËVE PËR VITIN KALENDARIK 2015/2016

Nr	Grup-mosha	Numri i fëmijëve
1.	0.9 muaj - 2 vjeç	8 fëmijë
2.	2-3 vjeç	14 fëmijë
3.	3-4 vjeç	16 fëmijë
4.	4-5 vjeç	11 fëmijë
5.	5-6 vjeç	11 fëmijë

Totali 60 fëmijë

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

1. Ekstrakti i lindjes së fëmijës;
2. Dëshmi që jeni banorë të lagjes Mati I apo II (vërtetimi nga Bashkësia Lokale; faturë të shërbimeve, dëshmi apo kontratë të pronës/vendbanimit etj)
3. Kontrata e punës për të dy prindërit (nëse punojnë të dy);
4. Gjendja e llogarisë bankare për të dy prindërit, për tre muajt e fundit;
5. Vërtetimin e kontributit nga Trusti Pensional për të dy prindërit (nëse punojnë të dy);
5. Dokumentet tjera valide të lëshuara nga institucionet relevante për të dëshmuar kategoritë tjera.

Çmimi i çerdhes është 100 euro në muaj.

Por në bazë të të ardhurave mujore që marrin të dy prindërit, Komuna e Prishtinës do të subvencionon një pjesë të pagesës:

1. Prindërit me të ardhura mujore deri në 500 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 50 euro në muaj për fëmijë.
2. Prindërit me të ardhura mujore deri në 700 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 30 euro në muaj për fëmijë.

3. Prindërit me të ardhura mujore deri në 1000 euro, Komuna i subvencionon me vlerë 20 euro në muaj për fëmijë.
4. Prindërit me të ardhura mujore mbi 1000 euro nuk do subvencionohen nga Komuna dhe paguajnë pagesën e plotë

Pranimi i dokumenteve bëhet prej datës 07 tetor 2015 deri më 15 tetor 2015.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në kopshtin “Ngjyrat” çdo ditë pune prej orës **10:00** deri në ora **16:00**. Shpallja e rezultateve bëhet më 19 tetor 2015 në kopshtin “Ngjyrat”.

Të gjithë të pakënaqurit me rezultatet e regjistrimit mund të ushtrojnë ankesë në kopshtin “Ngjyrat”, Hajvali, Prishtinë

Vërejtje: Të gjitha dokumentet dhe dëshmitë që dorëzohen do të verifikohen nga institucionet përkatëse dhe nëse ka dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit apo dëshmime do të humbni të drejtën për subvencionim të pagesës.